

BULETIN INFORMATIV

Janar - Dhjetor 2008

KOMISIONI PËR LEGJISLACION DHE GJYQËSI



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Dhjetor 2008



Në vitin e ngjarjeve të mëdha



Kosova, në vitin 2008, shënoi ngjarjet më të mëdha, në historinë e legjislacionit efektiv. Në këtë vit, vullneti i popullit u ngrit në normë dhe ngjarjet u ligjësuuan me akte: Pavarësia dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Aktivitetet e Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi, të sendërtuara si “Përpjekje për normativitet të strukturuar”, janë kurorëzuar me shtimin e sasisë dhe cilësisë së ligjeve dhe me respektimin e procedurave demokratike.

Tashmë, për herë të parë, krahas bërjes së ligjeve, edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, është bërë prioritet i punës së Komisionit.

Kohezioni veprues progresiv në mes të anëtarëve të Komisionit dhe zotimet e përnjëmendshme dhe profesionale: individuale, grupore e kolektive, i kanë dhënë cilësi të re punës së komisionit.

Përpjekjet e vazhdueshme të stafit të Komisionit, për ta mbështetur punën e Komisionit, kanë qenë të vetdukshme dhe të frytshme.

Programi Legjislativ i Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), i ka dhënë mbështetje të çmueshme Komisioni, në vitin 2008.

Bahri Hyseni

Kryetar i Komisionit



Fushëveprimi

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është komision funksional i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në fushën legjislativo - juridike.

- Propozon, sponsoron, amendamenton, ligje dhe akte të tjera të Kuvendit;
- Shqyrton bazushmërinë kushtetuese e të gjitha ligjeve që miratohen në Kuvend;
- Shqyrton metodologjinë e teknikën e hartimit të legjislacionit në Kosovë;
- Ka segment të caktuar të kompetencave në lëmin e gjyqësisë, në Kosovë;
- Mbikëqyrë zbatimin e ligjeve;
- Angazhon ekspertë për çështje të caktuara, nga fushëveprimi i Komisionit;
- Organizon dëgjime publike në fushat e caktuara të legjislacionit;
- Ushton veprimtari, sipas autorizimeve të Kuvendit dhe autorizimeve kushtetuese - ligjore.



Plani i Punës për vitin 2008

Komisioni për LGJ do të angazhohet maksimalisht për ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën jurisdiksonin e tij; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të organizojë tryeza të rrumbullakëta,

dëgjime publike dhe forma të tjera të bashkëpunimit, për grumbullimin e informatave, me qëllim të përmbushjes sa më të efektshme të detyrave nga fushëveprimi i vet; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të formojë grupe të punës, do të angazhojë ekspert, kur është e nevojshme, për të rritur efektivitetin e punës së tij; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve që i miraton Kuvendi; Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të bashkëpunojë rregullisht me të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të bashkëpunojë rregullisht me organizatat relevante ndërkombëtare: USAID, NDI, OSBE; Komisioni do të punojë drejtë ngritjes së cilësisë së punës dhe bashkëpunimit të brendshëm, si dhe ngritjes së kapacitetit të stafit për kryerjen e detyrave të tyre.



Mbledhjet e komisionit

Mbledhjet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, janë mbajtur konform Rregullores të Punës së Kuvendit. Të gjitha mbledhjet kanë pasur rrjedhë demokratike dhe kanë përfunduar me miratimin e formave juridike (vendime, propozime, mendime, përfundime, rekomandime), konform përmbajtjes së aktit dhe kërkesave për procedim.



Të gjitha vendimet apo format tjera juridike të përfundimit të shqyrtimit në Komision, janë miratuar me konsensus ose me shumicën e votave.

Asnjë mbledhje e thirrur, nuk ka dështuar të mbahet, për shkak të mungesës së kuorumit. Të gjitha

mbledhjet e Komisionit kanë qenë të hapura për publikun.

Në mbledhjet e Komisionit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e: USAID, NDI, OSBE, ICO e të tjerë.

Komisioni, në vitin 2008, ka mbajtur gjithsejtë 32 mbledhje të rregullta.

Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka shqyrtuar, amendamentuar dhe proceduar në Kuvend, të gjitha Projektligjet e sponsoruara nga Qeveria e Kosovës, në vitin 2008. Komisioni i ka shqyrtuar dhe amendamentuar edhe një numër të ligjeve, të cilat janë miratuar në Kuvend, por që nuk i ka nënshkruar Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB (PSSP), në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i Projektligjeve, të cilat kanë kaluar në Komision, gjatë këtij viti, është 22 (njëzetë e dy).



Komisioni ka shqyrtuar bazën juridike - kushtetuese e të gjitha projektligjeve që kanë kaluar në Kuvend. Mbi këtë bazë, janë shqyrtuar gjithsejtë 39 (tridhjetë e nëntë) projektligje.

Komisioni e ka përpiluar Projekt - Rezolutën për Dënimin e Krimeve të Regjimit Komunist. Po ashtu, Komisioni e ka sponsoruar Rregulloren e Punës së Komisioneve, e cila është në procedurë.

Për shqyrtimin e projektligjeve, komisioni ka caktuar: referues individual, grupe punuese dhe ekspertë, referimet e të cilëve iu kanë parapri shqyrtimeve në Komision.

Dëgjimet Publike

Komisioni ka mbajtur dy dëgjime publike, në ndërtesën e Kuvendit. Dëgjimet publike janë mbajtur, për projektligjet: Projektligji për Procedurën Kontestimore; Projektligji për Noterinë.



Dëgjimet publike kanë qenë të suksesshme. Në to kanë marrë pjesë: ekspertë të fushave përkatëse dhe shoqëria civile.

Angazhimi i ekspertëve

Komisioni, në bashkëpunim me NDI, ka angazhuar ekspertë të fushave përkatëse, për projektligjet: Procedura JoKontestimore; Procedura Përmbaruese. Këto ekspertiza, kanë dhënë kontribut të çmueshëm profesional për ligjësimin adekuat të fushave të përmendura.

Pjesëmarrja e ministrave në komision

Në mbledhjen e Komisionit, për: Ndryshimet dhe Plotësimet e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale; Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të datës 11 mars 2008, ka marrë pjesë dhe ka dhënë sqarime, Ministri i Drejtësisë, z. Nekibe Kelmendi.



Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në mbështetje të Rregullës 53 të Rregullores të Punës së Kuvendit.



Aktiviteti i Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, ka rrjedhur në dy shtretër:

1. Nxjerrja e dokumenteve infrastrukturale: Pani i veprimit, Regjistri ekzekutiv i dispozitave për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në institucionet korrektuese, Regjistri ekzekutiv i dispozitave për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në gjykata.

2. Mbajtja e takimeve mbikëqyrëse në terren, në: Burgun e Dubravës në Istog, Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe Gjykatën Komunale në Ferizaj.

Takimet kanë dhënë prova të bollshme, për nxjerrjen e p e r f u n d i m e v e dhe rekomandimeve kompetente, për nivelin dhe efektivitetin e zbatimit të Ligjit. I tërë aktiviteti dhe të gjitha të gjeturat janë përmbledhur në një raport të veçantë, i cili është miratuar në Komision dhe do të procedohet në Kuvend.

Statistika

Komisioni gjatë vitit 2008

- Mbledhje të komisionit	32
- Projektligje të shqyrtuara	22 + 39
- Grupe punuese të formuara	22
- Mbikëqyrje e ligjeve	1
- Vizita në terren	4
- Raportimi i ministrave në mbledhje	1
- Dëgjime publike	2

KOMISIONI PËR LEGJISLACION DHE GJYQËSI



Bahri Hyseni (PDK)
Kryetar i Komisionit



Adem Salihu (LDD)
Zëvendëskryetar i Parë



Branislav Grbić (SLS)
Zëvendëskryetar i Dytë



Ramadan Gashi (PDK)
Anëtar



Selvije Halimi (PDK)
Anëtare



Kolë Berisha (LDK)
Anëtar



Armend Zemaj (LDK)
Anëtar



Ibrahim Akolli (AKR)
Anëtar



Bajram Kosumi (AAK)
Anëtar



Adem Hajdaraj (LDK)
Anëtar



He Air Urati ()
Anëtar



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati për dhës

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Idriz Tahiri Administrator i Zyrës

038 211 306
idriz.tahiri@assembly-kosova.org

Fehmi Hyseni Zyrtar i Lartë Ligjor

038 213 807
fehmi.hyseni@assembly-kosova.org

Sulltane Gashi Nëpunëse Administrative

038 213 786
sulltane.gashi@assembly-kosova.org

Zyrtari mbështetës i Komisionit - NDI

Reshit Gashi Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 320, Kati III

038 212 532 regashi@gmail.com
044 124 415

Webfaqja i Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

